

KONTRIBUT RRETH NJOHJES SË LIKENOFLORËS TË BUTRINTIT

M. MURATI

Hyrja

Flora e RPSSH është relativisht mjaft e hulumtuar. Kjo shihet nga disa vepra që janë botuar deri më sot, si Flora e Tiranës nga Paparisto, Qosja dhe Demiri (1962), Dendroflora e Shqipërisë nga Mitrushit (1965), Flora e Korçës, Ersekës dhe Pogradecit nga Qosja (1973), Drurët dhe shkurret e Shqipërisë nga Mitrushit (1955) etj. Por kjo nuk do të thotë se flora e Shqipërisë është hulumtuar krejtësisht. Sidomos flora e bimëve të ulëta si algat, likenët dhe këpurdhat është pak e hulumtuar megjithëse botanistët Markgraf F, Csiki-Javorka-Kummerle kanë bërë studime edhe mbi likenoflorën e Shqipërisë (nga 16 speciet e mbledhura prej nesh, 11 janë mbledhur, jo në Butrint, nga këta autorë). Duke u bazuar në klimën, pedologjinë, gjeologjinë dhe bimësinë mendohet se Shqipëria është e pasur me një likenoflorë mjaft karakteristike dhe interesante. Kjo shifet edhe në qytetin e lashtë të Butrintit, të cilin patëm rastin ta vizitojmë dhe të mbledhim e më vonë të determinojmë disa lloje likenesh për të cilët do të bëhet fjalë në punimin tonë.

Materiali dhe metoda e punës

Materiali është mbledhur në qytetin e lashtë të Butrintit, kryesisht nëpër shkëmbinj, mure të vjetra, shtylla dhe drurë.

Përcaktimi i likeneve është bërë sipas Popnikollov dhe Zhelezovës (1964), Gams (1967), Kopaqevskaja, Makareviq, Oksner dhe Rasadina (1971). Gjatë përcaktimit kemi bërë edhe prerjen e talit dhe të trupave frytorë. Për reaksionin që japin acidet e likeneve si reagent kemi përdorur 10% KOH, mandej CaCl_2O_2 , HNO_3 etj.

Rezultatet e punës dhe diskutimi

Nga likenet e mbledhura ne përcaktuam 16 specie që bëjnë pjesë në dy klasa: Ascolichenes dhe Lichenes imperfecti. Të gjithë këto specie bëjnë pjesë në 10 familje. Familja që ka më tepër specie është Lecanoraceae, mandej Parmeliaceae etj. Speciet që përcaktuam janë:

- Caloplaca decipiens (Arn.) Jatta
- Caloplaca elegans (Link.) Th. Fr.
- Parmelia werruculifera Nyl.
- Parmelia saxatilis (L.) Ach.

Parmelia caperata (L.) Ach.
 Lecanora silesiaca Stein
 Lecanora intumescens (Rebent.) Rabnh.
 Collema sp. (Wigg.) A.Z.
 Lecidea parasema Nyl.
 Lepraria aeruginosa Sm.
 Xanthoria parietina (Chew.) Hillm.
 Physcia pulverulenta (Schreb.) Hampe.
 Nephroma resupinatum (L.) Ach.
 Cladonia pyxidata (L.) Tuck.
 Pertusaria pertusa (L.) Tuck.
 Pertusaria amara (Ach.) Nyl.

Të gjitha speciet e mësipërme jetojnë në substrate të ndryshme. Më poshtë do të përmendim substratin dhe speciet që jetojnë në të. Në substrat të fortë shkëmbor qelqëror, nëpër muret dhe shtyllat jetojnë këto specie: Caloplaca decipiens, Caloplaca elegans, Parmelia werruculifera, Parmelia saxatilis, Lecanora silesiaca, Collema sp, Cladonia pyxidata e tjerë. Nëpër kërcejt e bimëve drusore e sidomos të llojit Quercus coccifera rriten këto lloje: Parmelia caperata, Lecanora intumescens, Lecidea parasema, Lepraria aeruginosa, Xanthoria parietina, Physcia pulverulenta, Nephroma resupinatum, Pertusaria pertusa dhe Pertusaria amara. Për të gjitha speciet substrati është i njëjtë, ndërsa për specien Parmelia werruculifera, ai është në përgjithësi drunor (kërcej të ahut) me përjashtim të Butrintit ku paraqitet guror.

Përfundime

Rëndësia e këtij punimi qëndron në faktin se studiohet për herë të parë likenoflora e Butrintit.

Nga 16 speciet e mbledhura, 5 janë të reja për Shqipërinë, ndërsa 11, megjithëse janë gjetur nga të huajt, në Butrint janë takuar për herë të parë.

Përmbledhje

Në këtë punim kemi dhënë një pasqyrë të shkurtë mbi likenoflorën e Butrintit. Në këtë lokalitet kemi mbledhur 16 specie të likeneve që bëjnë pjesë në dy klasa: Ascolichenes dhe Lichenes imperfecti. Në klasën e fundit bën pjesë vetëm specia Lepraria aeruginosa, kurse speciet e tjera i takojnë klasës së parë. Speciet e gjetura jetojnë në substrate organike (në kërcejt e drurëve) dhe inorganike (nëpër shkëmbinj qelqësorë).

BIBLIOGRAFI

1. FREY E. (1970) — Les lichenes, Lausanne.
2. Gams (1967) — Klaine Kriptogamenflore. Gustav Fischer Verlag Shtutgart.
3. GRUMMANN V. (1963) — Catalogus lichenum Germaniane. Gustav Fischer Verlag Shtutgart.
4. KUSHAN F. (1953) — Prodromus lisaja Jugoslavije. JAZU Zagreb.
5. MITRUSHI, I. (1955) — Drurët dhe shkurret e Shqipërisë. «Mihal Duri» Tiranë.
6. PAPARISTO K., QOSJA XH., DEMIRI M. (1962) Flora e Tiranës. NISH «Mihal Duri». Tiranë.
7. PAVLETIQ Z., dhe MURATI M. (1977) Prilog poznavanju lisajeva Sar planine Acta Bot. Croat. 36, 165-171.
8. POPNIKOLLOV A., dhe ZHELEZOVA B. (1964): Flora na Blgarija — Lišei. «Narodna knjiga», Sofia.
9. CSIKI E, JAVORKA S., KUMERLEY B. Additamenta ad Floran Albaniae, 1926, Budapest.
10. MARKGRAF F. An den Grenzen des Mittelmeergebiets, 1927, Dahlem bei Berlin.

Résumé

CONTRIBUTION
POUR CONNAITRE LA LICHÉNOFLORE DE BUTRINT

L'auteur donne, dans cet article, un bref tableau de la lichénoflore de Butrint. Nous avons réuni dans cette localité 16 espèces de lichens faisant partie de deux classes: *Ascolichenes* et *Lichenes imperfecti*. De cette dernière classe fait partie la seule espèce *Lepraria aeruginosa*, cependant que les autres espèces appartiennent à la première classe.

Les espèces trouvées vivent dans des substrats organiques (les troncs des bois) et inorganiques (dans les roches calcaires).